



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO - REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KUSHTETUESE
USTAVNI SUD
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, më 2 qershor 2026
Nr.:ref.: AGJ3114/26

AKTGJYKIM

në

rastin nr. KI200/24

Parashtrues

Mehmet Prishtina

**Vlerësim i kushtetutshmërisë së kohëzgjatjes së procedurës gjyqësore përkitazi
me lëndën [PPKR. nr. 130/16] pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë –
Departamenti Special**

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Nexhmi Rexhepi, kryetar
Safet Hoxha, zëvendëskryetar
Bajram Ljatifi, gjyqtar
Radomir Laban, gjyqtar
Remzije Istrefi-Peci, gjyqtare
Enver Peci, gjyqtar dhe
Jeton Bytyqi, gjyqtar

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është parashtruar nga Mehmet Prishtina, më vendbanim në Komunën e Prishtinës (në tekstin e mëtejme: parashtruesi i kërkesës), i përfaqësuar nga Veton Rraci, jurist.

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës konteston kushtetutshmërinë e kohëzgjatjes së procedurës gjyqësore përkitazi me lëndën [PPKR. nr. 130/16] pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë – Departamenti Special (në tekstin e mëtejme: Gjykata Themelore).

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes së kërkesës është vlerësimi i kushtetutshmërisë së kohëzgjatjes së procedurës gjyqësore përkitazi me lëndën [PKR. nr. 130/16] përmes së cilit pretendohet se parashtruesit të kërkesës i janë shkelur të drejtat dhe liritë themelore të tij të garantuara me nenet: 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], 32 [E Drejta për Mjete Juridike], 33 [Parimi i Legalitetit] dhe 46 [Mbrojtja e Pronës] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta), në ndërlidhje me nenet 6 (E Drejta për një proces të rregullt), 7 (Nuk ka dënim pa ligj) dhe nenit 1 të Protokollit numër 1 (Mbrojtja e pronës) të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejme: KEDNJ).

Baza juridike

4. Kërkesa bazohet në paragrafët 1 dhe 7 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, në nenet 22 (Procedimi i kërkesës) dhe 47 (Kërkesa individuale) të Ligjit nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Ligji) dhe në rregullin 25 (Parashtrimi i kërkesave dhe përgjigjeve) të Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).
5. Parashtruesi i kërkesës gjithashtu ka kërkuar moszbulimin e identitetit të tij.

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

6. Më 19 shtator 2024, parashtruesi i kërkesës e dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata).
7. Më 15 tetor 2024, Kryetarja e Gjykatës përmes Vendimit [nr. GJR. KI200/24] caktoi gjyqtarin Bajram Ljatifi, gjyqtar raportues dhe anëtarët e Kolegjit shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Nexhmi Rexhepi (kryesues), Enver Peci dhe Jeton Bytyqi (anëtarë).
8. Më 10 dhjetor 2024, bazuar në paragrafin 5 të nenit 114 [Përbërja dhe Mandati i Gjykatës Kushtetuese] të Kushtetutës, rregullit 8 (Zgjedhja e Kryetarit/es dhe e Zëvendëskryetarit/es) të Rregullores së punës dhe Vendimit të Gjykatës [KK-SP 812-1/24], të 10 dhjetorit 2024, gjyqtari Nexhmi Rexhepi u zgjodh Kryetar i Gjykatës Kushtetuese. Bazuar në paragrafin 2 të rregullit 8 të Rregullores së punës dhe Vendimit të lartcekur të Gjykatës, u përcaktua që gjyqtari Nexhmi Rexhepi, detyrën e Kryetarit të Gjykatës e merr pas përfundimit të mandatit të Kryetares aktuale të Gjykatës, Gresa Caka-Nimani, më 30 dhjetor 2024. Të njëjtën ditë, përkatësisht më 10 dhjetor 2024, përmes Vendimit të Gjykatës [KK-SP 812-2/24] gjyqtari Safet Hoxha u zgjodh Zëvendëskryetar i Gjykatës, dhe bazuar në paragrafin 2 të rregullit 8 (Zgjedhja e Kryetarit/es dhe e Zëvendëskryetarit/es) të Rregullores së punës dhe Vendimit të lartcekur të Gjykatës u përcaktua që gjyqtari Safet Hoxha, detyrën e Zëvendëskryetarit e merr më 11 dhjetor 2024.
9. Më 30 dhjetor 2024, bazuar në paragrafin 2 të rregullit 8 të Rregullores së punës dhe Vendimit të Gjykatës [KK-SP 812-1/24], të 10 dhjetorit 2024, gjyqtari Nexhmi Rexhepi mori detyrën e Kryetarit të Gjykatës, ndërsa bazuar në nënparagrafin 1.1 të paragrafit 1 të nenit 8 (Përfundimi i mandatit) të Ligjit, Kryetarja Gresa Caka-Nimani përfundoi

mandatin e Kryetares dhe të gjyqtares së Gjykatës Kushtetuese. Në të njëjtën ditë, bazuar në nënparagrafin 1.1 të paragrafit 1 të nenit 8 të Ligjit, edhe gjyqtarja Selvete Gërxhaliu-Krasniqi përfundoi mandatin e gjyqtares së Gjykatës Kushtetuese.

10. Më 3 tetor 2024, Gjykata njoftoi parashtruesin e kërkesës për regjistrimin e kërkesës dhe kërkoi nga ai plotësimin e formularit të kërkesës. Në të njëjtën ditë, një kopje e kërkesës iu dërgua Gjykatës Themelore.
11. Më 7 tetor 2024, parashtruesi i kërkesës dorëzoi dokumente shtesë, përkatësisht formularin e kërkesës.
12. Më 4 prill 2025, Gjykata i dërgoi një shkresë Gjykatës Themelore, përmes së cilës kërkoi që në afat prej 7 (shtatë) ditësh, kjo e fundit të dorëzojë informatat e nevojshme lidhur me fazën në të cilën ndodhet shqyrtimi i lëndës fillestare, si dhe të dorëzojë procesverbalet e seancave të mbajtura pranë Gjykatës Themelore.
13. Me 16 prill 2025, Gjykata Themelore, dorëzoi informatën dhe dokumentet e kërkuara.
14. Më 12 maj 2026, Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin e gjyqtarit raportues dhe njëzëri i rekomandoi Gjykatës pranueshmërinë e kërkesës. Të njëjtën ditë, Gjykata në përbërje të plotë pas këshillimit, njëzëri vendosi: (i) të deklarojë kërkesën të pranueshme; (ii) të konstatojë, se ka pasur shkelje të paragrafit 2 të nenit 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, në lidhje me paragrafin 1 të nenit 6 (E drejta për një proces të rregullt) të Konventës Evropiane për të Drejta të Njeriut përkatësisht shkelje të së drejtës për gjykim brenda një afati kohor të arsyeshëm; (iii) të konstatojë, se Gjykata Themelore në Prishtinë-Departamenti Special duhet të veprojë me prioritet në përfundimin e procedurës penale dhe nxjerrjen e aktgjykimit meritor; si dhe (iv) të refuzojë kërkesën për moszbulim të identitetit.

Përmbledhja e fakteve

(i) Veprimet hetimore ndaj parashtruesit të kërkesës

15. Procedura penale ndaj parashtruesit të kërkesës filloi pas zhvillimit të veprimeve hetimore nga Prokuroria Speciale e Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: PSRK), lidhur me dyshimet për përfshirje në aktivitete të krimit të organizuar dhe përvetësim të kundërligjshëm të pronës shoqërore përmes procedurave gjyqësore civile. Hetimet ndërlidheshin me Aktgjykimin e Gjykatës Komunale të Prishtinës (në tekstin e mëtejshëm: Gjykata Komunale), rasti numër nr. [C. 724/2009], i cili është nxjerrë nga ish – gjyqtarja N. H., më 27 shtator 2010. Përmes këtij aktgjykimi D. E. kishte fituar të drejtën e pronësisë mbi 45 parcela tokësore me sipërfaqe prej 36.45 hektarësh, e cila i takonte ndërmarrjes shoqërore KBI Kosova-Export dhe Agjencisë Kosovare të Privatizimit e përbërë nga të gjitha parcelat kadastrale të renditura në listën poseduese me nr. 222 në vendin e quajtur “Mirkovica”-në Zonën Kadastrale Çagllavicë, dhe katër parcelave kadastrale të renditura në listën poseduese me nr. 125, në vendin e quajtur Veternik-,në Zonën Kadastrale Preoc. Sipas pretendimeve të PSRK-së, ky aktgjykim ishte nxjerrë në mënyrë të kundërligjshme nga ish-gjyqtarja N.H., në bashkëpunim me parashtruesin e kërkesës dhe të pandehur të tjerë, me qëllim të transferimit të kundërligjshëm të pronës shoqërore në pronësi private.
16. Më 6 mars 2014, Prokuroria Themelore në Prizren e filloi hetimin kundër dy të pandehurve: N. H., për kryerjen e veprës penale “Nxjerrja e kundërligjshme e vendimeve gjyqësore”, në shkelje të nenit 432 të Kodit nr. [04/L-082] Penal të Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: KPRK) dhe S. A., për kryerjen e veprës penale “Shpërdorimi i

pozitës zyrtare apo i autorizimit”, në shkelje të nenit 422 të KPRK-së. Numri i rastit në Prokurorinë Themelore ishte HP 154/2013.

17. Më 16 mars 2014, Prokuroria Themelore në Prizren e zgjeroi hetimin kundër parashtruesit të kërkesës, për veprën penale të *“Nxitjes së një personit tjetër (S. A.) për të kryer veprën penale Shpërdorim të pozitës zyrtare”*, në shkelje të nenit 422 në lidhje me nenin 32 të KPRK-së. Në të njëjtën datë, parashtruesi i kërkesës, në cilësi të të pandehurit, u mor në pyetje nga PSRK-ja.
18. Më 16 mars 2014, parashtruesi i kërkesës u ndalua prej orës 07:42 min, ndërsa është sjellë tek gjyqtarja e procedurës paraprake më 17 mars 2014 në ora 13:10 minuta.
19. Më 17 mars 2014, Gjykata Themelore në Prizren përmes Aktvendimit [Ppr. nr. 44/14] urdhëroi lirimin e parashtruesit të kërkesës nga ndalesa dhe u lëshua në liri. Përmes këtij aktvendimi gjithashtu ndaj parashtruesit të kërkesës u caktua edhe *masa e dorëzarisë*, për shkak të dyshimit të bazuar se ka kryer veprën penale *“shtytja në keqpërdorim të pozitës apo autoritetit zyrtar”*, nga neni 422, paragrafi 1 lidhur me nenin 32 të paragrafit 1 të KPRK-së. Parashtruesi i kërkesës u obligua të deponojë shumën e të hollave prej 50.000 euro.
20. Më 8 prill 2014, PSRK-ja pranoi një propozim për të marrë përsipër rastin penal nga Kryeprokurori i Prokurorisë Themelore në Prizren. Më 9 prill 2014, PSRK e lëshoi një vendim për të marrë përsipër rastin penal.
21. Më 5 qershor 2014, PSRK e zgjeroi hetimin kundër parashtruesit të kërkesës, për veprat penale të *“Krimin të Organizuar”*, në kundërshtim me nenin 283 të KPRK-së; dhe *“Pastrimit të Parave”* në kundërshtim me nenin 32, paragrafi 1 të Ligjit nr.03/L-96 për Parandalimin e Pastrimit të Parave dhe Financimit të Terrorizmit (në tekstin e mëtejshëm: LPSHPFT).
22. Më 8 gusht 2014, PSRK e zgjeroi hetimin kundër parashtruesit të kërkesës për veprën penale *“Shmangie nga tatimi”*, në kundërshtim me nenin 313 të KPRK-së.
23. Më 18 gusht 2015, PSRK e zgjeroi hetimin kundër parashtruesit të kërkesës për veprën penale *“plaçkitje, në bashkëkryerje”*, në kundërshtim me nenin 329, paragrafët 1 dhe 3 të KPRK-së.
24. Më 11 shkurt 2016, PSRK e zgjeroi hetimin ndaj parashtruesit të kërkesës për veprat penale: *“Ndihmë në kryerjen e veprës penale të Nxjerrja e kundërligjshme e vendimeve gjyqësore”*, në bashkëkryerje, në shkelje të nenit 33 dhe 31 të KPRK-së; *“Ndihmë në kryerjen e veprës penale të Shpërdorim i pozitës zyrtare ose i autorizimit”* në bashkëkryerje, në kundërshtim me nenin 33 dhe 31 të KPRK-së; dhe *“Falsifikim i Dokumentit Zyrtar”*, në bashkëkryerje, në shkelje të nenit 31 dhe 434 të KPRK-së.

(ii) Procedura për sekuestrimin/konfiskimin e pasurive/aseteve të parashtruesit të kërkesës

a) Pasuritë e paluajtshme

25. Më 18 mars 2014, Gjykata Themelore në Prizren lëshoi një urdhër për sekuestrimin e përkohshëm të pronave të paluajtshme në një sipërfaqe të përgjithshme prej 36.45.64 hektarë, siç ishin shënuar në Aktgjykimin nr. [C. 724/2009] e Gjykatës Komunale të 27 shtatorit 2010 dhe në dy certifikatat e të drejtave të pasurive të paluajtshme, të 2 prillit 2014 të lëshuar në emrat e parashtruesit të kërkesës dhe të pandehurit D. E. Gjykata

Themelore arsyetoi se parcelat e sipërshënuara konsiderohen dobi e fituar nga kryerja e veprave penale.

26. Më 29 gusht 2014, PSRK-ja bëri njëri kërkesë shtesë për urdhër ndalues ndaj pronave të parashtruesit të kërkesës, gruas së tij, dhe të D.E.
27. Më 27 nëntor 2014, Gjykata Themelore në Prizren bazuar në nenin 112 të KPPRK-së nxori një urdhër mbi sekuestrimin të përkohshëm [PPS 36/14] [PPKR 44/14] të të gjitha parcelave të tokës si dhe të dy pronave tjera në pronësi të parashtruesit të kërkesës, me arsyetimin se kishte dyshim të bazuar që pronat në fjalë ishin fituar nga kryerja e veprave penale.
28. Më 19 shkurt 2015, trupi gjykues për shqyrtim i Gjykatës Themelore të Prizrenit, përmes aktvendimit [PPrKR 44/14] [PPS36/14] i aprovoi kundërshtimet e parashtruara nga parashtruesi i kërkesës kundër urdhrit të 27 nëntorit 2014. Kolegji shqyrtues vlerësoi se PSRK-ja kishte nxjerrë urdhrin për konfiskim të përkohshëm më 18 mars 2014, por nuk e kishte ndjekur këtë urdhër me një kërkesë për masa të përkohshme për të siguruar pronën brenda periudhës së kërkuar 60 ditëshe.
29. Më 5 mars 2015, PSRK-ja bazuar në nenin 264, paragrafin 2 dhe nenin 265, paragrafin 3 të KPPRK-së lëshoi një urdhër për ngrirjen e përkohshme të aseteve dhe më pas bëri kërkesë për urdhër ndalues ndaj 47 ngastrave kadastrale të pronave të paluajtshme, në sipërfaqe prej 36.45.64 hektarë, në mënyrë që të parandalonte shitjen dhe bartjen e pronësisë. Të gjitha pronat ishin të specifikuar në Aktgjykimin nr. [C. 724/2009] e Gjykatës Komunale e 27 shtatorit 2010, në Zonën Kadastrale në Çagllavicë dhe Preoc. PSRK-ja pretendonte se i pandehuri D. E., e kishte fituar pronësinë mbi këto prona në mënyrë të jashtëligjshme dhe i kishte regjistruar në emër të tij. Tokat i kishte ndarë me parashtruesin e kërkesës dhe gruan e tij dhe më pas i shitën te personat e tjerë nën çmimet reale të tregut, me qëllim të përfitimit të dobisë pasurore. Disa nga këto toka mbetën në emër të D. E., dhe të parashtruesit të kërkesës.
30. Më 9 mars 2015, Gjyqtarja e procedurës paraprake e Gjykatës Themelore në Prizren e përmes urdhrit ndalues [PPR.Kr.44/14 PPS Nr. 36/14] miratoi kërkesën e PSRK-së për urdhrin ndalës së 5 marsit 2015. Gjyqtarja e procedurës paraprake duke u bazuar në nenin 19 të KPPRK-së lëshoi urdhër ndalues të përkohshëm ndaj tokave të specifikuar nga PSRK-ja, me arsyetimin se *“Duke marrë parasysh rezultatet e zbulimit financiar dhe në veçanti aktivitetet shumë të dyshimta financiare të të pandehurve Prishtina dhe Uka, si dhe kohën e transaksioneve të tyre financiare dhe blerjen e tokës, gjyqtarja e procedurës vie në përfundim se në këtë pikë është e arsyeshme të besohet se parcelat e tokës të përmendura nën piken B të dispozitivit janë fituar nga të ardhurat nga veprat penale të pretenduara”*. Rrjedhimisht, e konsideroi si të arsyeshëm dhe proporcional, parandalimin dhe bartjen e mëtejme të pronësisë së parcelave të tokës derisa pretendimet të jenë qartësuar. Përmes këtij urdhri Gjyqtarja e procedurës paraprake, caktoi seancë për të vendosur nëse duhej të lëshohej një urdhër ndalues afatgjatë.
31. Më 19 mars 2015, në Gjykatën themelore është mbajtur seanca dëgjimore në prani të prokurorit, të pandehurve dhe mbrojtësve të tyre, ku janë dëgjuar kundërshtimet e palëve me interes. Më 7 korrik 2014, PSRK-ja kishte lëshuar një *urdhër të përkohshëm për ngrirjen e llogarive bankare* të D. E., parashtruesit të kërkesës dhe gruas së tij.
32. Më 25 mars 2015, pas dëgjimit, gjyqtari i procedurës paraprake i Gjykatës Themelore lëshoi urdhrin ndalues afatgjatë [PPR.Kr.44/14 PPS Nr. 36/14], bazuar në nenin 264 dhe 265 të KPPRK-së, konfirmoi ngrirjen e pasurisë së paluajtshme që ishte subjekt i Urdhrit për ngrirje nga gjyqtarja e procedurës paraprake të 9 marsit 2014. Në fund u konstatua se ky urdhër mbetet në fuqi deri në përfundim të shqyrtimit gjyqësor dhe se

ndërprerja e hetimeve apo nëse xhirollogaritë bankare i nënshtrohen urdhrit afatgjatë të ngrirjes nuk janë dhënë në aktakuzë, në përputhje me Nenin 266, paragrafët 10 dhe 11 të KPP-së.

33. Nga shkresat e lëndës rezulton se më 15 maj 2015, Gjkata e Apelit, duke vendosur mbi ankesat e paraqitura nga ana e mbrojtësve të të pandehurve, e mbështeti urdhrin ndalues afatgjatë sa i përket 45 parcelave të cilat ishin objekt i aktgjykimit nr.[724/2009] të Gjykatës Komunale e 27 shtatorit 2010 me konstatimin se do të mbetet në fuqi deri në përfundim të shqyrtimit gjyqësor në këtë rast.

a) llogaritë bankare

34. Më 7 korrik 2014, PSRK-ja kishte lëshuar një *urdhër të përkohshëm për ngrirjen e llogarive bankare* të D. E., parashtruesit të kërkesës dhe gruas së tij.
35. Më 9 korrik 2014, Gjkata Themelore në Prizren nxori urdhër ndalues të përkohshëm ndaj 41 (dyzet e një) llogarive bankare të parashtruesit të kërkesës dhe gruas së tij dhe D. E., me arsyetimin se PSRK-ja kishte prova se këto llogari bankare ishin pjesë e transaksioneve të paligjshme të tyre.
36. Nga shkresat e lëndës rezulton se më 30 korrik 2014, gjyqtari i procedurës paraprake në përputhje me paragrafi 8 të nenit 265 dhe nenit 266 të KPP-së, mbajti një seancën për "*Konfirmimin e Ndalimit të Pronës*". Mbrojtja e parashtruesit të kërkesës e kundërshtoi urdhrin dorëzoi një vërejtje me shkrim në lidhje me ngrirjen e llogarive bankare si dhe plotësimin e parashtrësës me gojë.
37. Më 4 gusht 2014 PSRK-ja paraqiti përgjigjen e saj ndaj avokatit mbrojtës të parashtruesit të kërkesës në lidhje me parashtrësat e paraqitura.
38. Më 6 gusht 2014, Gjkata Themelore e Prizrenit nxori *urdhër ndalues afatgjatë* [PPS. nr. 36/14] [PKR. nr. 44/14], ndaj llogarive bankare të të lartcekurve.
39. Më 19 gusht 2024, mbrojtja e parashtruesit të kërkesës paraqiti ankesë kundër urdhrit të gjyqtarit të procedurës paraprake të Gjykatës Themelore të 6 gusht 2014, për ndalimin afatgjatë të tri llogarive bankare të tij.
40. Më 16 shtator 2014, Gjkata e Apelit, [nr. PN 463/14],(Gj/TH në Prizren PPKR 44/14) duke vepruar sipas ankesës së parashtruesit të kërkesës, e la në fuqi urdhrin e 6 gushtit 2014 të Gjykatës Themelore të Prizrenit.

(iii) Aktakuza e ngritur nga PSRK-ja

41. Më 3 mars 2016, PSRK-ja ngriti Aktakuzë [PPS Nr.: 36/2014] pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë kundër parashtruesit të kërkesës dhe 22 të pandehurve të tjerë. Në vijim do të pasqyrohen pikat e aktakuzës ndaj parashtruesit të kërkesës, që përfshijnë: (i) veprat penale për të cilat akuzohet parashtruesi i kërkesës (ii) baza ligjore për sekuestrim/konfiskim dhe (iii) provat që kërkohen për të arsyetuar konfiskimin.

(i) Veprat penale për të cilat akuzohet parashtruesi i kërkesës

- *Krimi i organizuar*, në kundërshtim me nenin 274, paragrafët 1, 2 dhe 3 të Kodit të mëparshëm Penal të Kosovës, që është zbatuar deri më 31 dhjetor të vitit 2013, dhe që është paraparë edhe me nenin 283 të Kodit të Ri Penal të Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: KPRK), i zbatueshëm nga janari i vitit 2013.

- *Ndihma në kryerjen e veprës penale të nxjerrjes së vendimeve gjyqësore të paligjshme*, në bashkëkryerje, në kundërshtim me nenet 25 dhe 23 të KPRK-së, i zbatueshëm deri me datën 31 dhjetor 2012, dhe që është paraparë edhe me nenet 33 dhe 31 të KPRK-së, i zbatueshëm nga janari i vitit 2013.
 - *Ndihma në kryerjen e veprës penale të keqpërdorimit të detyrës zyrtare*, në bashkëkryerje, në kundërshtim me nenet 25 dhe 23 të KPRK-së deri me datën 31 dhjetor të vitit 2012, dhe që është paraparë edhe me nenet 33 dhe 31 KPRK-së, i zbatueshëm nga janari i vitit 2013.
 - *Plaçkitja*, në bashkëkryerje, në kundërshtim me nenin 23 dhe 255 paragrafët 1, 2 dhe 3 të KPRK-së, i zbatueshëm deri me datën 31 dhjetor të vitit 2012, dhe që është paraparë edhe me nenin 33 dhe 329 (1, 2 dhe 3) të KPRK-së, i zbatueshëm nga janari i vitit 2013.
 - *Falsifikimi i dokumenteve zyrtare*, në bashkëkryerje me S. A., (dëshmitare bashkëpunuese), në kundërshtim me nenet 23 dhe 348 të KPRK-së, i zbatueshëm deri me datën 31 dhjetor të vitit 2012, dhe që është paraparë edhe me nenin 31 dhe 434 të KPRK-së, i zbatueshëm nga janari i vitit 2013.
 - *Ndihma në kryerjen e veprës penale të keqpërdorimit të pozitës zyrtare ose autorizimit*, në kundërshtim me nenin 25 të KPRK-së, i zbatueshëm deri me datën 31 dhjetor të vitit 2012, dhe që është paraparë edhe me nenet 33 dhe 31 të KPRK-së, i zbatueshëm nga janari i vitit 2013.
 - *Shpërlarja e parave në vazhdimësi*, në kundërshtim me nenin 71 të KPRK-së, i zbatueshëm deri me datën 31 dhjetor të vitit 2012, dhe që është paraparë edhe me nenin 81 të Kodit të ri Penal të Kosovës, i zbatueshëm nga janari i vitit 2013, dhe me paragrafin 2 të nenit 32 të Ligjit Nr. 03 /L-196 për Parandalimin e Pastrimit të Parave dhe Parandalimin e Financimit të Terrorizmit, i zbatueshëm nga 30 shtatori i vitit 2010, që është paraparë me nenin 308 të KPRK-së, i zbatueshëm nga janari i vitit 2013.
42. Më 15 dhjetor 2022, parashtruesi i kërkesës iu drejtua me parashtrësë Gjykatës Themelore në lidhje me parashkrimin e veprave penale të parashikuara nga aktakuza e PSRK-së, e 3 marsit 2016.
43. Nga shkresat e lëndës rezulton se në lidhje me këtë kërkesë nuk iu është kthyer përgjigje.
- (ii) Baza ligjore për sekuestrim/konfiskim si pjesë e aktakuzës
44. PSRK-ja e arsyetoi sekuestrimin e pasurive në përputhje me nenin 96 të KPRK-së – baza për konfiskimin e përfitimeve materiale – asnjë person nuk mund ta mbajë dobinë pasurore të fituar me vepër penale; dobia pasurore do të konfiskohet. Në bazë të nenit 276 të KPRK-së, dobia pasurore e fituar me vepër penale mund të jetë e drejtpërdrejtë ose jo e drejtpërdrejtë, dhe konkretisht: Ndërtesa, pasuria e paluajtshme, pasuria e luajtshme ose aseti që është fituar drejtpërdrejt nëpërmjet veprimeve që përbëjnë vepër penale. Në këtë aktakuzë theksohet se janë përmbushur kushtet nga neni 276 të KPRK-së, përkatësisht paragrafët 1 dhe 2, janë të aplikueshëm në lidhje me parcelat e tokës dhe llogaritë bankare.
45. Sipas PSRK-së, pronësia e parcelave të tokës të cilat janë objekt i kësaj aktakuze është fituar nga i pandehuri D. E., me anë të veprave penale të kryera nga ai, parashtruesi i kërkesës dhe e pandehura N. H. Pronësia e këtyre parcelave ishte transferuar nga emri i D. E., te personat e tjerë të cilët i kishin blerë ato për çmime shumë të ulëta nga vlera

reale e tregut, për të fshehur faktin se ato ishin përfituar në mënyrë kriminale. Pjesë e këtij grupi ishte edhe parashtruesi i kërkesës. Paratë të cilat ishin marrë si rezultat i shitjeve të këtyre parcelave të tokës janë të fituara në mënyrë të drejtpërdrejtë nga veprimet kriminale dhe janë të jashtëligjshme.

46. Në bazë të nenit 266 [Shqyrtimi për konfirmimin e ndalimit të pasurisë], paragrafit 11 të KPPRK-së, pronat e evidentuara në urdhrin për ndalim afatgjatë në aktakuzë, janë si në vijim:

- *45 ngastra kadastrale: 41 në Zonën Kadastrale Cagllavicë, 4 në Zonën Kadastrale Preoc.*
- *Llogaritë bankare të parashtruesit të kërkesës: 4 llogari në Raifaisen bank; 3 në BKT; 5 në Teb bank; 4 në NLB bank.*

(iii) Provat që kërkohen për të arsyetuar konfiskimin

47. PSRK-ja u bazua në nenin 275, paragrafin 1 të KPPRK-së, që përcakton se aktakuza duhet të përshkruaj provat e duhura që kërkohen për të arsyetuar konfiskimin. PSRK-ja arsyetoi se provat e marra nga Gjermania përmes ndihmës juridike ndërkombëtare në lidhje me historinë e parashtruesit të kërkesës e mbështesin edhe më tej lëshimin e një urdhri për konfiskim. Autoritete gjermane e kishin informuar prokurorinë që parashtruesi i kërkesës kurrë nuk kishte punuar zyrtarisht; nuk ka pasur llogari bankare; nuk ka pasur në pronësi ndonjë pronë në Gjermani, dhe se është dënuar për vepër penale që ndërlidhet me substanca narkotike, i dënuar me shtatë vjet burgim. B. U., bashkëshortja e parashtruesit të kërkesës, ka mbajtur dy llogari bankare. Autoritetet gjermane tatimore kishin deklaruar se parashtruesi i kërkesës i detyrohet një borxhi të madh në taksa të papaguara. Këto fakte e kundërshtojnë deklarinë e parashtruesit të kërkesës për gjendjen e tij të mirë në Gjermani, dhe tregon për prirjen e tij për të vepruar në mënyrë të kundërligjshme ndaj autoriteteve, veçanërisht kur bëhet fjalë për financa.
48. PSRK-ja e citoi raportin e ekspertizës nga KPMG me ekspertin [M.P] të 30 korrikut 2015, në të cilin është konstatuar se transaksionet në lidhje me parcelat e tokës, transaksionet ndërmjet D. E., dhe parashtruesit të kërkesës dhe palës së tretë të blerësve (të pandehurit e tjerë) janë të paligjshme. Vlerësohej se blerësit nuk ishin blerës në mirëbesim dhe në vend të kësaj ata kanë blerë këto pjesë të tokës për çmime që janë paarsyeshëm të ulëta dhe e dinin, apo është dashur të dinë se si pasojë e kësaj këto parcelat e tokës janë marrë në mënyrë të paligjshme. Palët e treta që kanë marrë pjesë në shitjen e tokës, të tilla si A. M., dhe SH. M., e donin, ose duhej të kishin dijeni se origjina e tokës ishte e paligjshme.
49. Sipas PSRK-së, llogaritë bankare të B.U., janë përfshirë pasi që ajo është gruaja e parashtruesit të kërkesës, e cila nuk ka profesion ose të ardhura zyrtare por ka disa llogari bankare. Vlerësohet se të gjitha fondet në këto llogari bankare duhet të rrjedhin nga veprimet e parashtruesit të kërkesës. Kjo mbështetet në informatat e marra nga Gjermania, ku vlerësohet se ajo i ka mbajtur më herët llogarinë bankare për çiftin.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

50. Parashtruesi i kërkesës pretendon që kohëzgjatja e procesit gjyqësor përkitazi me lëndën [PPKR. nr. 130/16] pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë, ka shkelur të drejtat e tij kushtetuese të garantuara me nenet 31, 32, 33 dhe 46 të Kushtetutës, në lidhje me nenet 6, 7 dhe nenit 1 të Protokollit numër 1 të KEDNj-së. Këto pretendime do të pasqyrohen si më poshtë.

(i) *Pretendimet për shkeljen e paragrafit 2 të nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me paragrafin 1 të nenit 6 të KEDNJ-së, përkitazi me kohëzgjatjen e procedurës gjyqësore*

51. Parashtruesi i kërkesës thekson se: [...] Nga marsi i vitit 2016, kur është ngritur aktakuza, deri në momentin e paraqitjes së kësaj kërkesë (gusht 2024), kanë kaluar plot tetë (8) vite e katër (4) muaj. Edhe pas kalimit të kësaj kohe të gjatë, Gjykata Themelore në Prishtinë nuk ka marrë kurrë asnjë vendim për këtë rast”. Sipas parashtruesit të kërkesës, rasti nuk është përfunduar pavarësisht insistimit dhe kërkesave të vazhdueshme të tij që rasti të zgjidhet sa më shpejt. Sipas tij, kjo vonesë e paarsyeshme e Gjykatës Themelore përbën kohëzgjatje të procedurës dhe për pasojë përbën shkelje të paragrafit 2 të nenit 31 të Kushtetutës, i cili garanton të drejtën për gjykim të drejtë brenda afatit të arsyeshëm kohor.
52. Parashtruesi i kërkesës thekson se kohëzgjatja e procesit gjyqësor në këtë rast, ka shkaktuar dëm të madh për të sepse ndihet i pafajshëm, por edhe për integritetin dhe efektivitetin e sistemit të drejtësisë në Kosovë.
53. Parashtruesi i kërkesës i referohet praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së dhe të Gjykatës në lidhje me kohëzgjatjen e procedurave gjyqësore. Ai thekson se është e domosdoshme që Gjykata Themelore në Prishtinë të marrë masa të menjëhershme për të zgjidhur rastin e tij dhe të sigurojë që procedurat gjyqësore të zhvillohen në përputhje me standardet kushtetuese dhe ndërkombëtare, duke mbrojtur të drejtat e individëve dhe duke promovuar një sistem të drejtë dhe efikas të drejtësisë.

(ii) *Pretendimet për shkeljen e nenit 32 të Kushtetutës*

54. Parashtruesi i kërkesës thekson se më 22 dhjetor 2022 iu drejtua me parashtrësë Gjykatës Themelore në Prishtinë, përmes së cilës i kërkoi që të vepronte në pajtim me legjislacionin në fuqi mbi faktin se disa vepra penale të pikave të aktakuzës ishin parashkruar në mënyrë absolute. Ai thekson se, duke mos vendosur mbi këtë ankesë të tij, iu cënua e drejta për mjete juridike e paraparë me nenin 32 të Kushtetutës; si dhe të drejtës për mbrojtje gjyqësore nga neni 54 i Kushtetutës.

(iii) *Pretendimet për shkeljen e nenit 33 të Kushtetutës në lidhje me nenin 7 të KEDNJ-së*

55. Parashtruesi i kërkesës thekson se përmes shkresës së 14 dhjetorit 2022, i është drejtuar Gjykatës Themelore në Prishtinë për ta liruar atë nga përgjegjësia penale për veprat penale që janë parashkruar. Mosveprimi i Gjykatës Themelore në këtë drejtim, sipas tij, përbën shkelje të të drejtave kushtetuese të garantuara me nenin 33 të Kushtetutës ndërlidhur me parimin e legalitetit dhe Proporcionalitetit në Rastet Penale. Vazhdimi i procedurës gjyqësore për veprat penale që janë parashkruar dëmton të drejtat e parashtruesit të kërkesës dhe dëmton besimin në sistemin e drejtësisë.
56. Parashtruesi i kërkesës pretendon që është shkelur edhe neni 7 i KEDNJ-së, i cili përcakton se nuk ka dënim pa ligj. Ky parim kërkon që asnjë individ të mos dënohet për një vepër penale që nuk parashikohet me ligj. Sipas tij, vazhdimi i procedurës gjyqësore për veprat penale që kanë arritur parashkrimin absolut janë në kundërshtim me këtë parim të rëndësishëm të së drejtës ndërkombëtare.
57. Parashtruesi i kërkesës kërkon nga Gjykata që të urdhëroj Gjykatën Themelore në Prishtinë që të vendos mbi parashkrimin e veprave penale sipas kërkesës së 14 dhjetorit 2022.

(iv) *Pretendimet për shkeljen e nenit 46 të Kushtetutës në lidhje me nenin 1 të Protokollit numër 1 të KEDNJ-së*

58. Parashtruesi i kërkesës thekson se më 6 gusht 2014, Gjykata Themelore në Prizren ka nxjerrë urdhrin e ndalimit afatgjatë [PPS. nr. 26/14] [nr. 44/14], me të cilën janë ngrirë katër llogari bankare. Këto llogari mbesin të bllokuara për plot 10 vite. Më 5 mars 2015, me urdhër të ndalimit afatgjatë, ai thekson se atij i janë bllokuar asetet, përfshirë tokat me sipërfaqe prej 36 hektarë e 45 ari, të cilat gjenden në zonën kadastrale të Çagllavicës.
59. Parashtruesi i kërkesës thekson se me Aktvendimin [PPR. nr. 44/14] e Gjykatës Themelore të Prizrenit të 17 marsit 2014, në emër të dorëzarisë, i ka deponuar 50.000 euro, të cilat janë të bllokuara për 10 vite e 5 muaj.
60. Parashtruesi i kërkesës pretendon se bllokimi i llogarive bankare, tokave dhe parave të dorëzarisë, i kanë shkaktuar dëme materiale dhe jomateriale. Sipas tij, *“Duke i mbajtur të bllokuara për më shumë se 10 vite, Gjykatat e Kosovës i kanë shkelur të drejtat e pronës të garantuara nga neni 46 (Mbrotjtja e Pronës) i Kushtetutës së Kosovës”*.
61. Parashtruesi i kërkesës kërkon nga Gjykata që të: (i) Urdhërojë Gjykatën Themelore në Prishtinë që menjëherë t’i zhbllokojë asetet dhe pasuritë e lartpërmendura; dhe (ii) T’i njohë të drejtën për kompensim material nga ana e shtetit për dëmin e shkaktuar nga mbajtja e bllokuar për mbi 10 vite të këtyre pasurive.
62. Në fund, më 7 tetor 2024, parashtruesi i kërkesës dorëzoi në Gjykatë formularin e kërkesës në të cilin specifikoi që identiteti i tij të mos zbulohet, mirëpo i njëjti nuk ofroi asnjë arsyetim.

Përgjigja e Gjykatës Themelore

63. Gjykata Themelore përmes përgjigjes së saj njoftoi Gjykatën se: **(i)** në Departamentin Special, është duke u zhvilluar procedurë penale ndaj parashtruesit të kërkesës dhe të tjerëve, sipas aktakuzës së Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës, si dhe në përputhje me procesverbalet e shqyrtimeve gjyqësore; **(ii)** kjo lëndë ka qenë në trajtim nga gjyqtarja tashmë e ndjerë Sh.G., janë caktuar një mori seancash gjyqësore dhe janë dëgjuar shumë dëshmitarë lidhur me këtë çështje të propozuar nga Prokuroria Speciale; **(iii)** në këtë fazë të procedurës ka mbetur për t’u dëgjuar vetëm edhe një dëshmitare, e quajtur S.A., për sigurimin e së cilës gjykata ka ndërmarrë veprime të vazhdueshme për ta siguruar pjesëmarrjen e saj në seancat e shqyrtimit gjyqësor, megjithatë nga fletëkthesat e gjykatës është konstatuar se adresa e dëshmitares është e panjohur, për çka gjykata ka lëshuar urdhëresë Policisë së Kosovës, me qëllim të verifikimit të adresës së saj. Pas veprimeve të ndërmarra nga Policia e Kosovës, është kthyer përgjigje se dëshmitarja në fjalë nuk gjendet në adresën e shënuar në ftesën e gjykatës; **(iv)** Trupi Gjykues i ka njoftuar palët në procedurën penale për të gjitha veprimet e ndërmarra me qëllim të sigurimit të kësaj dëshmitareje.
64. Në këtë përgjigje gjithashtu theksohet se, prokurori i çështjes, si dhe të akuzuarit së bashku me mbrojtësit e tyre, nuk kanë pranuar që të lexohet dëshmia e saj e dhënë në Policinë e Kosovës me autorizim të prokurorit. Prokurori ka theksuar se dëshmitarja në fjalë është bashkëpunuese me prokurorinë, ndërsa të akuzuarit dhe mbrojtësit e tyre e konsiderojnë atë si dëshmitare relevante për këtë çështje juridiko-penale, me arsyetimin se, në momentin kur ajo ka dhënë dëshminë në Policinë e Kosovës, pala e akuzuar dhe mbrojtësit e saj nuk kanë pasur mundësi ta sfidojnë këtë dëshmitare. Për këtë arsye, ata kanë propozuar që të bëhet përpjekja maksimale për sigurimin e saj në shqyrtimin e ardhshëm gjyqësor; dhe **(v)** në këtë fazë, Trupi Gjykues ka mbetur që, për

sigurimin e dëshmitares në seancën e ardhshme gjyqësore, t'i drejtohet me shkresë Ministrisë së Drejtësisë, Departamentit për Bashkëpunim Juridik Ndërkombëtar, kjo për faktin se, sipas disa informatave jozyrtare që gjykata disponon, dëshmitarja S. A. gjendet në shtetin e Gjermanisë

Dispozitat relevante kushtetuese dhe ligjore

Kushtetuta e Republikës së Kosovës

Neni 31

[E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm]

- 1. Çdokujt i garantohet mbrojtje e barabartë e të drejtave në procedurë para gjykatave, organeve të tjera shtetërore dhe bartësve të kompetencave publike.*
- 2. Çdokush gëzon të drejtën për shqyrtim publik të drejtë dhe të paanshëm lidhur me vendimet për të drejtat dhe obligimet ose për cilëndo akuzë penale që ngrihet kundër saj/tij brenda një afati të arsyeshëm, nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e themeluar me ligj.*
[...]

Neni 33

[Parimi i Legalitetit dhe Proporcionalitetit në Rastet Penale]

- 1. Askush nuk mund të akuzohet ose të dënohet për asnjë vepër e cila, në momentin e kryerjes, nuk ka qenë e përcaktuar me ligj si vepër penale, me përjashtim të veprave të cilat, në kohën e kryerjes së tyre, sipas së drejtës ndërkombëtare, përbënin gjenocid, krime lufte ose krime kundër njerëzimit.*
[...]

Neni 32

[E Drejta për Mjete Juridike]

“Secili person ka të drejtë të përdorë mjetet juridike kundër vendimeve gjyqësore dhe administrative të cilat cenojnë të drejtat ose interesat e saj/tij në mënyrën e përcaktuar me ligj.”

Neni 46

[Mbrojtja e Pronës]

- 1. E drejta e pronës është e garantuar.*
- 2. Shfrytëzimi i pronës rregullohet me ligj, në pajtim me interesin publik.*
[...]

Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut

Neni 6

(E drejta për një proces të rregullt gjyqësor)

Çdo person ka të drejtë që çështja e tij të dëgjohet drejtësisht, publikisht dhe brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e krijuar me ligj, e cila do të vendosë si për mosmarrëveshjet në lidhje me të drejtat dhe detyrimet e tij të natyrës civile, ashtu edhe për bazueshmërinë e çdo akuze penale në ngarkim të tij [...].

Neni 7
Nuk ka dënim pa ligj

1. Askush nuk mund të dënohet për një veprim ose një mosveprim që, në momentin kur është kryer, nuk përbënte vepër penale sipas të drejtës së brendshme ose ndërkombëtare. Po ashtu, nuk mund të jepet një dënim më i rëndë se ai që ishte i zbatueshëm në momentin kur është kryer vepra penale.
[...]

Neni 1 [Protokolli shtesë numër 1]
Mbrojtja e pronës

Çdo person fizik ose juridik ka të drejtën e gëzimit paqësor të pasurisë së tij. Askush nuk mund të privohet nga prona e tij, përveçse për arsye të interesit publik dhe në kushtet e parashikuara nga ligji dhe nga parimet e përgjithshme të së drejtës ndërkombëtare.
[...]

Vlerësimi i pranueshmërisë së kërkesës

65. Gjykata së pari vlerëson nëse parashtruesi i kërkesës i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara në Kushtetutë dhe të parashikuara më tej në Ligj dhe në Rregullore të punës.
66. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet paragrafëve 1 dhe 7 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, në lidhje me nenet 47, 48 dhe 49 të Ligjit.

Neni 113
[Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara]

“1. Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.
[...]
7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj”.
[...]

Neni 47
(Kërkesa individuale)

“1. Çdo individ ka të drejtë të kërkojë nga Gjykata Kushtetuese mbrojtje juridike në rast se pretendon se të drejtat dhe liritë e tij individuale të garantuara me Kushtetutë janë shkelur nga ndonjë autoritet publik.
2. Individ i mund ta ngritë kërkesën në fjalë vetëm pasi që të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj”.

Neni 48
(Saktësimi i kërkesës)

“Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj”.

Neni 49
(Afatet)

“Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajve. Afati fillon të ecë që nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor...”.

67. Në vijim, Gjykata i referohet rregullit 34 (1) (b) të Rregullores së punës, i cili përcakton që:
*“(1) Gjykata mund ta konsiderojë një kërkesë të pranueshme nëse:
 [...] (b) janë shteruar të gjitha mjetet efektive të përcaktuara me Ligj kundër aktgjyqimit ose vendimit të kontestuar ”*
68. Rrjedhimisht, Gjykata rikujton se, sipas paragrafit 1 të nenit 47 (Kërkesa individuale) të Ligjit, çdo individ ka të drejtë të kërkojë mbrojtje juridike nga Gjykata Kushtetuese në rast se konsideron se të drejtat dhe liritë e tij të garantuara me Kushtetutë janë shkelur nga ndonjë autoritet publik. Sipas paragrafit 2 të të njëjtit nen, individ mund ta parashtrojë kërkesën në fjalë vetëm pasi të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj.
69. Në lidhje me plotësimin e kriterëve të sipërcekura të pranueshmërisë, Gjykata thekson se parashtruesi i kërkesës është palë e autorizuar i cili konteston kohëzgjatjen e procedurës përkitazi me lëndën [PPKR. nr. 130/16] me pretendimin se i është shkelur e drejta për një gjykim brenda një afati kohor të arsyeshëm, e garantuar me nenin 31 të Kushtetutës dhe nenin 6 të KEDNJ-së.
70. Parashtruesi i kërkesës gjithashtu, pretendon (i) shkelje të neneve 32 dhe 33 të Kushtetutës, për shkak të parashkrimit të disa veprave penale si dhe (ii) shkelje të nenit 46 të Kushtetutës, për shkak të bllokimit të aseteve, përkatësisht pronave të paluajtshme, llogarive bankare dhe mjeteve të dorëzanisë.
71. Në lidhje me pretendimet për shkelje të neneve 32, 33 dhe 46 të Kushtetutës, Gjykata fillimisht do të vlerësojë nëse parashtruesi i kërkesës e ka përmbushur kriterin e shterimit të mjeteve juridike të përcaktuara me ligj, siç kërkohet me paragrafin 7 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, paragrafin 2 të nenit 47 (Kërkesa individuale) të Ligjit dhe pikën (b) të paragrafit (1) të rregullit 34 (Kriteret e pranueshmërisë) të Rregullores së Punës.
72. Në mbështetje të kësaj, Gjykata fillimisht thekson se rregulli i lartpërmendur, bazuar në praktikën gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejshëm: GJEDNJ) dhe të Gjykatës, e detyron këtë të fundit të vlerësojë përmbushjen e kriterëve lidhur me shterimin e mjeteve juridike të përcaktuara me ligj dhe të deklarojë kërkesat e papranueshme, nëse ky nuk është rasti.
73. Gjykata rikujton pretendimin e parashtruesit të kërkesës që ka të bëjë me parashkrimin absolut të veprës penale për të cilën theksoi se: *“[...] disa nga veprat penale për te cilat ai akuzohet tashmë kanë arritur parashkrimin absolut. Në përputhje me këtë, me 14 dhjetor 2022, parashtruesi ka dorëzuar një kërkesë në Gjykatë për nxjerrjen e një aktgjykimi refuzues, që do ta lironte atë nga përgjegjësia penale për veprat që janë parashkruar. Mosveprimi i Gjykatës në këtë drejtim përbën një shkelje të qarte të të drejtave të parashtruesit”*. Rrjedhimisht, parashtruesi i kërkesës shton se veprimet e Gjykatës Themelore kanë shkelur edhe nenin 7 të KEDNJ-së, i cili e rregullon parimin se nuk ka dënim pa ligj, duke theksuar se [...] *procedurat për veprat që kanë arritur parashkrimin absolut, Gjykata Themelore në Prishtinë ka vepruar në kundërshtim me këtë parim të rëndësishëm të së drejtës ndërkombëtare për të drejtat e njeriut”*.
74. Gjykata, gjithashtu rikujton se parashtruesi i kërkesës para Gjykatës pretendon shkelje të së drejtës në pronë të garantuar përmes nenit 46 të Kushtetutës, pasi që sipas tij Gjykata Themelore përmes urdhrit të ndalimit afatgjatë [PPS. nr. 26/14] dhe [nr. 44/14], të 6 gushtit 2014, ka ngrirë katër llogari bankare, të cilat sipas tij kanë mbetur të

bllokuara për rreth dhjetë (10) vite. Po ashtu, ai thekson se përmes një urdhri tjetër të ndalimit afatgjatë të 5 marsit 2015, i janë bllokuar edhe asetet e tij, përfshirë tokat me sipërfaqe 36 hektarë e 45 ari në zonën kadastrale të Çagllavicës. Rrjedhimisht, parashtruesi i kërkesës thekson se sipas Aktvendimit [PPR. nr. 44/14] të Gjykatës Themelore të 17 marsit 2014, në emër të dorëzarisë ka deponuar 50,000 euro, të cilat sipas tij kanë mbetur të bllokuara për dhjetë (10) vite e pesë (5) muaj.

75. Në rastin konkret, Gjykata rikujton se PSRK-ja ka ngritur aktakuzë në Gjykatën Themelore kundër parashtruesit të kërkesës dhe njëzet e dy (22) të pandehurve të tjerë me dyshimin e bazuar se kanë kryer një sërë veprash penale. Në kuadër të kësaj aktakuze është kërkuar edhe konfiskimi i aseteve që i nënshtrohen konfiskimit në përputhje me nenin 96 të KPRR-së dhe paragrafët 1 dhe 2 të nenit 276 të KPPRK-së, përfshirë pasurinë e paluajtshme dhe llogaritë bankare. Po ashtu, në përputhje me paragrafin 1 të nenit 275 të KPPRK-së, në aktakuzë është paraqitur edhe një përmbledhje e provave që arsyetojnë kërkesën për konfiskim.
76. Gjykata po ashtu rikujton se, bazuar në shkresat e lëndës, procedura lidhur me çështjen në fjalë ende ndodhet në fazën e shqyrtimit pranë Gjykatës Themelore, në lëndën [PPRK. nr. 130/16]. Përderisa ende nuk është marrë një vendim përfundimtar lidhur me aktakuzën e ngritur ndaj parashtruesi i kërkesës për veprat penale për të cilat ai akuzohet, Gjykata vlerëson se parashtruesi i kërkesës nuk mund të pretendojë në këtë fazë shkelje të të drejtave të tij pronësore. Rrjedhimisht, çështja që ndërlidhet konfiskimin/ e pasurive, të përcaktuar me Aktakuzën e PSRK-së, të 3 marsit 2016 e cila është ende objekt shqyrtimi në Gjykatën Themelore.
77. Në këtë kontekst, dhe duke u bazuar në parimin e mirë të vendosur se procedura penale duhet të vlerësohet në tërësinë e saj, Gjykata konsideron se pretendimet e parashtruesit të kërkesës lidhur me zhvillimin e procedurës hetimore, të cilat ndërlidhen me aktakuzën e ngritur ndaj tij mund të parashtrohen dhe shqyrtohen në procedurën e shqyrtimit gjyqësor (shih rastin e Gjykatës, KI35/23, parashtrues *Pajtim Shabani*, Aktvendim për papranueshmëri, i 7 qershorit 2023, paragrafët 38-55).
78. Në këtë drejtim, Gjykata rithekson praktikën e saj gjyqësore, e cila në parim njeh tri kategori të rasteve kur kërkesa e paraqitur mund të shpallet e papranueshme për shqyrtim për shkak të mosshterimit të mjeteve juridike të përcaktuara me ligj, e ku njëra nga këto raste është kategoria e “*kërkesës së parakohshme*” (shih ndër të tjera, rastet e Gjykatës [KI09/19](#), me parashtrues *Leutrim Hajdari*, Aktvendim për papranueshmëri i 5 shkurtit 2020, paragrafët 40-43; [KI179/20](#), me parashtrues *Telekom i Kosovës Sh.A.*, Aktvendim për papranueshmëri, i 27 janarit 2021, paragrafi 95; dhe [KI49/22](#), me parashtrues *Zejnel Ninaj*, Aktvendim për papranueshmëri i 30 gushtit 2023, paragrafi 59; dhe rastet e GJEDNJ-së [Bilsena Šahman kundër Bosnje dhe Hercegovinës](#), nr. 40110/16, Vendim i 25 prillit 2017 dhe [Alenka Šaver kundër Sllovenisë](#), nr. 18105/13, Vendim i 7 shkurtit 2017).
79. Andaj, nga kjo rezulton se dhënia e përparësisë së mbrojtjes gjyqësore të të drejtave para gjykatave të rregullta dhe e drejta për mjete efektive juridike, është një aspekt shumë i rëndësishëm i mbrojtjes së të drejtave të njeriut që duhet të merret parasysh nga gjykatat e rregullta dhe e cila merret parasysh edhe nga Gjykata Kushtetuese nëse një rast i tillë paraqitet para saj nga palët e autorizuar dhe pas plotësimit të kritereve të pranueshmerisë, duke përfshirë edhe shterimin e mjeteve juridike.
80. Bazuar në shkresat e lëndës, rezulton që procedura lidhur me çështjen në fjalë është ende në fazën e shqyrtimit në Gjykatën Themelore. Në dritën e të lartcekurave, Gjykata marrë për bazë faktin që procedura penale ndaj parashtruesit të kërkesës, përkatësisht shqyrtimi gjyqësor në procedurë penale ndaj tij është në zhvillim e sipër dhe bazuar në

parimin e mirë të vendosur që procedura penale duhet të vlerësohet në tërësinë e saj, parashtruesi i kërkesës, pretendimet e tij që ndërlidhen me parashkrimin e veprave penale dhe konfiskimin e aseteve dhe të pasurisë së tij: (i) mund ti ngritë në procedurë të shqyrtimit gjyqësor; (ii) duke iu referuar garancive të përcaktuara me Kushtetutë dhe KEDNJ; dhe (iii) parimeve dhe standardeve të vendosura përmes praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së në harmoni me të cilën, sipas nenit 53 të Kushtetutës, gjykatat janë të detyruara të interpretojnë të drejtat dhe liritë themelore të garantuara me Kushtetutë.

81. Në dritën e elaborimit si më sipër, Gjykata, marrë për bazë faktin që aktakuza e ngritur nga PSRK-ja kundër parashtruesit të kërkesës, për kryerjen e disa veprave penale, është duke u gjykuar pranë Gjykatës Themelore, Gjykata konsideron se kërkesa e parashtruesit të kërkesës përkitazi me pretendimin për shkeljen e neneve 32, 33 dhe 46 të Kushtetutës, cilësohet si kërkesë e kategorisë të "*kërkesës së parakohshme*" dhe rrjedhimisht, kërkesa refuzohet në pajtim me nenin 47 (Kërkesa individuale) të Ligjit dhe pikën (b) të paragrafit (1) të rregullit 34 (Kriteret e pranueshmërisë) të Rregullores së punës.
82. Prandaj në kuptim të respektimit të parimit të subsidiaritetit, Gjykata vlerëson se kërkesa e parashtruesit të kërkesës lidhur me pretendimet për shkelje të neneve 32, 33 dhe 46 të Kushtetutës në këtë fazë të procedurës është e parakohshme.
83. Gjykata thekson se ky konstatim i Gjykatës nuk paragjykon rastin e parashtruesit të kërkesës përkitazi me aktakuzën e ngritur ndaj tij dhe nuk e pengon parashtruesin e kërkesës që në të ardhmen, sërish të dorëzojë kërkesë kushtetuese në lidhje me këto pretendime brenda afatit ligjor pas shterimit të të gjitha mjeteve efektive juridike të përcaktuara me legjislacionin në fuqi.
84. Si përfundim, nga arsyet e shtjelluara si më sipër, Gjykata konstaton që pretendimi i parashtruesit të kërkesës për shkeljen e të drejtës në pronë të cilësohet si kërkesë e kategorisë së "*kërkesës së parakohshme*", dhe rrjedhimisht, kërkesa refuzohet në pajtim me nenin 47 (Kërkesa individuale) të Ligjit dhe pikën (b) të paragrafit (1) të rregullit 34 (Kriteret e pranueshmërisë) të Rregullores së punës.
85. Në vijim të vlerësimit të kërkesës së parashtruesit e që ndërlidhet me kohëzgjatjen e procedurës penale në lëndën [PPKR. nr. 130/16] në Gjykatën Themelore, Gjykata do të vazhdojë me vlerësimin e këtij pretendimi specifik në kontekst të së drejtës së tij për "*gjykim brenda një afati kohor të arsyeshëm*", e garantuar me paragrafin 2 të nenit 31 të Kushtetutës dhe paragrafin 1 të nenit 6 të KEDNJ-së.

Meritat e kërkesës

86. Gjykata fillimisht rikujton se, procedura penale ndaj parashtruesit të kërkesës ka filluar pas veprimeve hetimore të ndërmarra nga PSRK në lidhje me dyshimet për përfshirje në krim të organizuar dhe përvetësim të kundërligjshëm të pronës shoqërore përmes procedurave gjyqësore civile. Hetimet formale në këtë rast kanë filluar më 6 mars 2014 nga Prokuroria Themelore, fillimisht ndaj të pandehurës N. H. dhe S. A. Më pas, më 16 mars 2014, hetimi është zgjeruar edhe ndaj parashtruesit të kërkesës, i cili në të njëjtën datë është marrë në pyetje si i dyshuar nga organet e ndjekjes penale. Më 16 mars 2014, parashtruesi i kërkesës është ndaluar përkohësisht, ndërsa më 17 mars 2014 është liruar nga ndalesa me vendim të Gjykatës Themelore, e cila i ka caktuar edhe masën e dorëzimit në shumën prej 50,000 euro. Më 9 prill 2014, PSRK-ja ka marrë përsipër rastin penal. Më pas, hetimet ndaj parashtruesit të kërkesës janë zgjeruar në disa faza në atë: më 5 qershor 2014 për veprën penale "*krimin të organizuar*" dhe "*pastrimit të parave*"; më 8 gusht 2014 për veprën penale "*shmangie nga tatimi*"; më 18 gusht 2015 për veprën penale "*plaçkitje në bashkëkryerje*"; dhe më 11 shkurt 2016 për veprën penale "*Ndihmë*".

në kryerjen e veprave penale të Nxjerrja e kundërligjshme e vendimeve gjyqësore në bashkëkryerje"; "Ndihmë në kryerjen e veprës penale të Shpërdorim i pozitës zyrtare ose i autorizimit" në bashkëkryerje dhe "Falsifikim i Dokumentit Zyrtar", në bashkëkryerje. Paralelisht me hetimin penal, janë ndërmarrë edhe masa të sigurimit pasuror. Më 18 mars 2014 është urdhëruar sekuestrimi i përkohshëm i 45 parcelave të paluajtshme, ndërsa më 27 nëntor 2014 dhe 5 mars 2015 janë vendosur urdhra ndalues dhe ngrirje të aseteve. Gjykata rikujton se këto masa janë konfirmuar dhe vazhduar nga Gjykata Themelore dhe më pas nga Gjykata e Apelit më 15 maj 2015. Më 3 mars 2016 PSRK-ja ka ngritur aktakuzë kundër parashtruesit të kërkesës dhe 22 të pandehurve të tjerë, për një sërë veprash penale, përfshirë krimin e organizuar, keqpërdorimin e detyrës zyrtare, falsifikimin e dokumenteve, plaçkitjen dhe pastrimin e parave, duke pretenduar se përmes veprimeve të tyre është përvetësuar në mënyrë të kundërligjshme prona shoqërore dhe janë realizuar përfitime të paligjshme financiare. Pas ngritjes së aktakuzës, për këtë procedurë gjyqësore ende nuk është marrë një vendim meritior lidhur me rastin.

87. Parashtruesi i kërkesës pretendon se, si rezultat i kohëzgjatjes së paarsyeshme të procedurës gjyqësore lidhur me aktakuzën për të cilën ende nuk është marrë një vendim përfundimtar nga Gjykata Themelore, atij i është shkelur e drejta e tij për një gjykim brenda një afati të arsyeshëm, siç garantohet me paragrafin 2 të nenit 31 të Kushtetutës dhe paragrafin 1 të nenit 6 të KEDNJ-së. Në lidhje me këtë, parashtruesi i kërkesës thekson se që nga momenti i ngritjes së aktakuzës ndaj tij, më 3 mars 2016, kanë kaluar më shumë se tetë (8) vite e katër (4) muaj dhe çështja ende nuk është zgjidhur nga Gjykata Themelore, përkundër kërkesave të tij që rasti të zgjidhet sa më shpejt. Parashtruesi i kërkesës pretendon se kjo vonesë e paarsyeshme i ka shkaktuar atij dëm të madh dhe përbën shkelje të paragrafit 2 të nenit 31 të Kushtetutës, që garanton "një gjykim brenda afatit të arsyeshëm kohor".
88. Gjykata në vijim do të trajtojë këtë pretendim të parashtruesit të kërkesës, në lidhje me kohëzgjatjen e procedurës për lëndën [PPKR. nr. 130/16] në Gjykatën Themelore, duke aplikuar parimet e zhvilluara përmes praktikës gjyqësore të Gjykatës dhe ato të vendosura përmes praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së, në harmoni me të cilën, në bazë të nenit 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut] të Kushtetutës, ajo është e detyruar të interpretojë të drejtat dhe liritë themelore të garantuara me Kushtetutë.

I. Parimet e përgjithshme përkritazi me të drejtën për "gjykim brenda një afati të arsyeshëm"

89. Gjykata rikujton se paragrafi 2 i nenit 31 të Kushtetutës përcakton se: "Çdokush gëzon të drejtën për shqyrtim publik të drejtë dhe të paanshëm lidhur me vendimet për të drejtat dhe obligimet ose për cilëndo akuzë penale që ngrihet kundër saj/tij brenda një afati të arsyeshëm, nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme [...]".
90. Ndërsa, paragrafi 1 i nenit 6 të KEDNJ-së përcakton se: "Çdo person ka të drejtë që [...] të dëgjohet [...] brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë [...], e cila do të vendosë [...] në lidhje me të drejtat dhe detyrimet e tij [...]".
91. Prandaj, bazuar në dispozitat e lartcekura, e drejta për një vendim brenda një afati të arsyeshëm është pjesë përbërëse e të drejtës për gjykim të drejtë dhe të paanshëm të garantuar me nenin 31 të Kushtetutës dhe nenin 6 të KEDNJ-së.
92. Lidhur me këtë, Gjykata rikujton që parimet dhe kriteret e vendosura përmes praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së në kontekst të së drejtës për vendim brenda afatit të arsyeshëm kohor në rastet penale i ka aplikuar në rastin [KI75/23](#) dhe [KI225/23](#) (parashtrues Ilir Efendija dhe Ilir Beqiri, Aktgjykim i 5 shkurtit 2025). Thënë këtë, Gjykata në aplikimin

parimeve dhe standardet e GJEDNJ-së ka theksuar se qëllimi i paragrafit 2 të nenit 31 të ndërlidhur me nenin 6 të KEDNJ-së, me të cilin garantohet e drejta e secilit për një gjykim brenda afatit të arsyeshëm kohor, është që të sigurojë se i akuzuari nuk do të mbetet për shumë gjatë nën akuzë, në gjendje të pasigurisë në lidhje me vendimin ndaj tij. Neni 6 nuk parasheh ndonjë të drejtë në lidhje me rezultatin e procesit penal (shih rastin e lartcekur më lartë [KI75/23 dhe KI225/23](#) të Gjykatës; dhe rastin e GJEDNJ-së, [Kart kundër Turqisë](#), nr.8917/05, Aktgjykim i 3 dhjetorit 2009, paragrafi 68).

93. Në procedurën penale, koha e arsyeshme për zgjidhjen e çështjes sipas paragrafit 2 të nenit 31 të Kushtetutës, ndërlidhur paragrafin 1 të nenit 6 të KEDNJ-së fillon nga momenti kur personi akuzohet. Akuza konsiderohet se ekziston nga momenti kur individ i njoftohet zyrtarisht nga autoritetet kompetente për dyshimin se ai ka kryer veprë penale, ose nga momenti kur ai është prekur në mënyrë substanciale nga veprimet e autoriteteve publike si rezultat i dyshimit serioz ndaj tij, (shih, rastin e Gjykatës [KI75/23 dhe KI225/23](#), cituar më lart, paragrafi 92 dhe rasti i GJEDNJ-së, [Kaleja kundër Latvisë](#), nr.22059/08, Aktgjykim i 5 tetorit 2017, paragrafi 36).
94. Thënë këtë, Gjykata bazuar në kriterin e vendosur nga GJEDNJ-së ka vlerësuar se periudha që merret parasysh përfshin të gjithë procesin penal në tërësi, përfshirë edhe procedurën e ankimimit (shih, rastin e Gjykatës [KI75/23 dhe KI225/23](#), cituar më lart, paragrafi 92 dhe rasti i GJEDNJ-së, [Konig kundër Gjermanisë](#), nr. 6232/73, Aktgjykim i 28 qershorit 1978, paragrafi 98).
95. Gjykata ka specifikuar që arsyeshmëria e kohëzgjatjes së procedurës penale duhet të vlerësohet në bazë të rrethanave të rastit, që kërkon një vlerësim të përgjithshëm, megjithatë ashtu siç ka specifikuar edhe GEJDNJ, në kontekstin e administrimit të mirëfilltë të drejtësisë kërkohet një balancim i drejtë i disa aspekteve që janë fundamentale. Thënë këtë, arsyeshmëria e kohëzgjatjes së procedurës duhet të vlerësohet mbi bazën e kriterëve siç janë: (i) ndërlikueshmëria e rastit, (ii) sjellja e palës, (iii) sjellja e autoriteteve dhe (iv) ajo se çfarë është në rrezik për palën e akuzuar (shih, rastin e Gjykatës [KI75/23 dhe KI225/23](#), cituar më lart, paragrafët 92-93 dhe referencat e përdorura aty si rasti i GJEDNJ-së, [Boddaert kundër Belgjikës](#), nr. 12919/87, Aktgjykim i 12 tetorit 1992, paragrafët 36 dhe 39; dhe [Idalov kundër Rosisë](#), nr. 5826/03, Aktgjykim i 22 majit 2012, paragrafi 186).
96. Në këtë drejtim, GJEDNJ në rrethana konkrete të rasteve kishte vlerësuar se ndërlikueshmëria e rastit mund të përcaktohet nga faktorë të ndryshëm si numri i akuzave, numri i personave të përfshirë në procedurën penale (të akuzuarit apo dëshmitarët) (shih rastin e GJEDNJ-së, [Neumeister kundër Austrisë](#), nr.1936/63, Aktgjykim i 27 qershorit 1968, paragrafi 20); apo kur akuzat penale lidhen me shpëlarjen e parave (shih, rastin e GJEDNJ-së, [Arewa kundër Lituanisë](#), nr. 16031/18, Aktgjykim i 9 marsit 2021, paragrafi 52). Megjithatë, ndërlikueshmëria e rastit, siç mund të jenë akuzat për krim të organizuar, ku janë të përfshirë numër i madh i të akuzuarve, megjithatë nuk mund të përbëjë shkak për ta arsyetuar gjithë kohëzgjatjen e procesit penal (shih rastin e GJEDNJ-së, [Rutkowski dhe të tjerët kundër Polonisë](#), nr. 72287/10, 13927/11 dhe 46187/11, Aktgjykim i 7 korrikut 2015, paragrafi 137).
97. Përderisa lidhur me sjelljen e autoriteteve, Gjykata duke iu referuar praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së thekson se është detyrë e shtetit të organizojë sistemin e drejtësisë në mënyrë të tillë që do t'i mundësonte gjykatave të përfundojnë çështjen brenda afatit të arsyeshëm kohor (shih, rastin e GJEDNJ-së, [Dimitrov dhe Hamanov kundër Bullgarisë](#), nr. 48059/06 dhe 2708/09, Aktgjykim i 19 majit 2011, paragrafi 71). Gjykatat mbajnë përgjegjësi për mospjesëmarrjen e palëve të përfshira në procesin penal, si të akuzuarit, përfaqësuesit e tyre apo dëshmitarët. Është detyrë e tyre t'i disiplinojë palët (shih, rastin

e GJEDNJ-së, [Tychko kundër Rusicë](#), nr.56097/07, Aktgjykim i 11 qershorit 2015, paragrafi 68).

98. Në vijim dhe lidhur me sjelljen e palëve, Gjykata duke u bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së ka afirmuar se në rrethanat e rasteve penale me nenin 31 të Kushtetutës, në ndërlidhje me nenin 6 të KEDNJ-së nuk kërkon që palët të bashkëpunojnë aktivisht me autoritetet gjyqësore kompetente; dhe as nuk mund të fajësohen palët për përdorimin e të gjitha mjeteve juridike në dispozicion. Megjithatë, këto veprime nuk mund t'i atribuohen autoriteteve dhe duhet të merren parasysh gjatë vlerësimit nëse procedura ka zgjatur përtej afatit të arsyeshëm (shih, rastin e Gjykatës [KI75/23 dhe KI225/23](#), cituar më lart, paragrafët 92-93; dhe rastin e GJEDNJ-së, [Eckle kundër Gjermanisë](#), nr. 8130/78, Aktgjykim i 15 korrikut 1982, paragrafi 82;).
99. Në fund, dhe lidhur me kriterin e asaj se çfarë është në rrezik për palën, Gjykata rikujton vlerësimin e GJEDNJ-së ku ka theksuar se ajo se çfarë është në rrezik për palën duhet të merret si faktorë për ta përcaktuar arsyeshmërinë e kohëzgjatjes së procesit penal. Për shembull, kur një person është në vuajtje të paraburgimit, autoritetet duhet të veprojnë me shpejtësi dhe kujdes të shtuar (shih rastin e Gjykatës [KI75/23 dhe KI225/23](#), *parashtrues Ilir Efendijs dhe Ilir Beqiri*, Aktgjykim i 5 shkurtit 2025, paragrafi 97 dhe rastin e GJEDNJ-së, [Abdoella kundër Holandës](#), nr.12728/87, Aktgjykim i 25 nëntorit 1992, paragrafi 24;).

II. Vlerësimi i Gjykatës

Kohëzgjatja e procedurës penale

100. Në lidhje me kohëzgjatjen e procedurës penale, Gjykata vëren se më 16 mars 2014 Prokuroria Themelore në Prizren e zgjeroi hetimin ndaj parashtruesit të kërkesës për veprën penale *“nxitjes së një personi tjetër (S. A.) për të kryer veprën penale shpërdorim të pozitës zyrtare”*, në kundërshtim të nenit 339 të KPRK-së në lidhje me nenin 24 të KPK-së mëparshëm, të paraparë edhe me nenin 422 në lidhje me nenin 32 të KPK-së së ri. Parashtruesi i kërkesës, në të njëjtën ditë, u mor në pyetje nga PSRK-ja në cilësi të të pandehurit. Me 5 qershor 2014, PSRK e zgjeroi hetimin ndaj parashtruesit të kërkesës nën dyshimin (i) për veprën penale të *“Krimin të Organizuar”*, në kundërshtim me nenin 274 të KPK-së mëparshëm, që parashihet edhe me nenin 283 të KPK-së të ri; si dhe (ii) për veprën penale të *“Pastrimit të Parave”* në kundërshtim me paragrafin 1, të nenit 32 të LPSHPFT-së; Më 16 mars 2014, parashtruesi i kërkesës është ndaluar përkohësisht, ndërsa më 17 mars 2014 është liruar nga ndalesa me vendim të Gjykata Themelore, e cila i ka caktuar edhe masën e dorëzimit në shumën prej 50,000 euro. Më 18 mars 2014, Gjykata Themelore kishte lëshuar një urdhër për sekuestrim të përkohshëm të pronave në sipërfaqe prej 36.45 hektarë të evidentuara në emër të parashtruesit të kërkesës dhe të pandehurit D. E., pas të cilit më 7 korrik 2014, PSRK-ja lëshoi një urdhër të përkohshëm për ngrirjen e llogarive bankare të parashtruesit të kërkesës dhe gruas së tij. Në fund, më 3 mars 2016, PSRK-ja ngrii aktakuzë ndaj parashtruesit të kërkesës dhe 22 të pandehurve të tjerë.
101. Gjykata, gjithashtu rikujton pretendimin e parashtruesit të kërkesës, i cili thekson se që nga momenti i ngritjes së aktakuzës më 3 mars 2016, kanë kaluar tetë (8) vite e katër (4) muaj, dhe se Gjykata Themelore nuk ka nxjerrë ende ndonjë vendim.
102. Gjykata thekson se hetimet penale ndaj parashtruesit të kërkesës, caktimi i masës së dorëzimit dhe urdhri për sekuestrimin e përkohshëm të pasurive kishin afektuar në mënyrë substanciale pozitën e parashtruesit të kërkesës.

103. Megjithatë, Gjykata vlerëson se procedura penale ndaj parashtruesit të kërkesës ka filluar më 16 mars 2014, në momentin kur ndaj tij janë ndërmarrë hetime dhe ai është marrë në pyetje nga organet kompetente. Ndërkaq, kërkesa në Gjykatë është parashtruar më 19 shtator 2024. Për qëllim të vlerësimit të kohëzgjatjes së procedurës penale, Gjykata merr parasysh periudhën nga fillimi i procedurës deri në paraqitjen e kërkesës në Gjykatë. Në rastin konkret, kjo periudhë përfshinë dhjetë (10) vite, gjashtë (6) muaj dhe tre (3) ditë.
104. Për të arritur një përfundim se a është zgjidhur rasti i parashtruesit të kërkesës brenda një afati të arsyeshëm, Gjykata më tej do të vlerësojë (i) ndërlikueshmërinë e rastit, (ii) sjelljen e palës, (iii) sjelljen e autoriteteve kompetente, si dhe (iv) rëndësinë e asaj që është në rrezik për palën në kontestin gjyqësor.

(i) Përkitazi me ndërlikueshmërinë e rastit

105. Për sa përket ndërlikueshmërisë së rastit, Gjykata bazuar në shkresat e lëndës vëren se në rastin konkret procedura penale ka qenë relativisht komplekse, duke marrë parasysh natyrën dhe numrin e veprave penale për të cilat akuzohej parashtruesi i kërkesës. Gjykata vëren se PSRK-ja kishte ngritur aktakuzë ndaj parashtruesit të kërkesës për kryerjen e shtatë (7) veprave penale, përfshirë krimin e organizuar, ndihmën në kryerjen e veprës penale të nxjerrjes së vendimeve gjyqësore të paligjshme, keqpërdorimit të detyrës zyrtare, plaçkitjes, falsifikimit të dokumenteve zyrtare, keqpërdorimit të pozitës zyrtare apo autorizimit, si dhe shpërlarjes së parave në vazhdimësi. Sipas aktakuzës, parashtruesi i kërkesës paraqitej si një nga anëtarët kryesorë të një grupi kriminal, i cili së bashku me të bashkëpandehurit kishte përfituar në mënyrë të kundërligjshme pronësi mbi parcela toke me sipërfaqe prej 36.45 hektarësh, duke shkaktuar dëme në miliona euro ndaj interesit publik. Gjykata po ashtu vëren se aktakuza ishte ngritur ndaj gjithsej njëzetë e dy (22) të pandehurve, ndërsa gjatë shqyrtimit gjyqësor ishte propozuar dëgjimi i njëmbëdhjetë (11) dëshmitarëve civilë, një ekspert, shtatë (7) palëve të dëmtuara, të gjithë të pandehurit dhe administrimi i një numri të konsiderueshëm të provave materiale.
106. Bazuar në numrin e të pandehurve, natyrën dhe seriozitetin e akuzave, si dhe volumin e provave dhe dëshmimeve që duhej administruar, Gjykata vlerëson se çështja ka pasur një shkallë të caktuar ndërlikueshmërie. Megjithatë, pavarësisht rrethanave të lartcekura, Gjykata konsideron se kompleksiteti i çështjes, në vetvete, nuk mund të justifikojë zgjatjen e procedurës për një periudhë kaq të gjatë kohore, veçanërisht në mungesë të veprimeve procedurale efikase dhe ndërmarrjes së veprimeve të vazhdueshme për vazhdimin dhe zhvillimin e procedurës gjyqësore penale në Gjykatën Themelore.

(ii) Përkitazi me sjelljen e parashtruesit të kërkesës

107. Lidhur me sjelljen e palëve, Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës kishte marrë pjesë pothuajse në të gjitha seancat gjyqësore të mbajtura gjatë zhvillimit të procedurës penale. Nga shkresat e lëndës rezulton se ai kishte munguar vetëm në një seancë gjyqësore gjatë vitit 2023, për shkak të së cilës seanca ishte shtyrë. Gjykata po ashtu merr parasysh përgjigjen e Gjykatës Themelore, sipas së cilës prokurori i çështjes, si dhe të akuzuarit së bashku me mbrojtësit e tyre, nuk kishin pranuar që të lexohej deklarata e një dëshmitareje e dhënë në Policinë e Kosovës me autorizim të prokurorit. Në këtë drejtim, prokurori kishte theksuar se dëshmitarja ishte bashkëpunuese me prokurorinë, ndërsa të akuzuarit dhe mbrojtësit e tyre e konsideronin atë si dëshmitare relevante për çështjen juridiko-penale dhe kishin kërkuar mundësinë për ta sfiduar drejtpërdrejt dëshmitaren, me arsyetimin se në kohën kur ajo kishte dhënë deklaratën në polici nuk kishin pasur mundësi ta kundërshtonin apo ta merrnin në pyetje. Përveç kësaj rrethane dhe mungesës së vetme në një seancë, Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës kishte

bashkëpunuar me gjykatën dhe kishte ndërmarrë veprimet procedurale të nevojshme për zhvillimin e rregullt të procedurës.

108. Në këtë kontekst, Gjykata konsideron se sjellja e parashtruesit të kërkesës nuk ka ndikuar në kohëzgjatjen e procedurës penale. Gjykata vlerëson se kundërshtimi i leximit të deklaratës së dëshmitares nuk përbënte përpjekje për zvarritjen e procedurës, por ushtrim të së drejtës për mbrojtje efektive dhe të parimit të kontradiktoritetit, përkatësisht të drejtës së palës së akuzuar për të sfiduar provat dhe dëshmitarët e propozuar nga prokuroria. Për më tepër, duke pasur parasysh seriozitetin e akuzave të ngritura ndaj tij, si dhe sekuestrimin e provave, ishte në interesin e vet parashtruesit që procedura të përfundonte brenda një afati të arsyeshëm. Rrjedhimisht, Gjykata vlerëson se parashtruesi i kërkesës nuk kishte përdorur mjete apo mënyra për të zvarritur procedurën.

(iii) *Sjellja e autoriteteve kompetente*

109. Gjykata, në vlerësimin e sjelljes së autoriteteve kompetente, vëren se nga shkresat e lëndës dhe procesverbalet e dorëzuara nga Gjykata Themelore rezulton se kjo e fundit kishte ndërmarrë një sërë veprimesh procedurale për zhvillimin e procedurës penale. Konkretisht, Gjykata vëren se çështja ishte trajtuar fillimisht nga gjyqtarja tashmë e ndjerë Sh. G., gjatë së cilës periudhë ishin caktuar një numër i konsiderueshëm seancash gjyqësore dhe ishin dëgjuar shumë dëshmitarë të propozuar nga Prokuroria Speciale. Nga procesverbalet e dorëzuara nga Gjykata Themelore rezulton se vetëm gjatë periudhës 2022–2024 ishin mbajtur trembëdhjetë (13) seanca gjyqësore, ndërsa disa të tjera ishin shtyrë apo anuluar.

110. Gjykata vëren se në bazë të përgjigjes së dhënë nga Gjykata Themelore, theksohet se:

"[...] Duke vepruar sipas kërkesës së juaj për dhënien e informatave shtese lidhur me rastin e juaj KI 200/24, ju informojmë se në këtë gjykatë – në Departamentin Special është duke u zhvilluar procedura penale ndaj të akuzuarit Mehmet Prishtina e tjerë, për veprat penale si në Aktakuzën e Prokurorisë Speciale të R. së Kosovës dhe në procesverbalet e shqyrtimeve gjyqësore, andaj ju informoj se për këtë çështje juridiko penale nga momenti kur e kam pranuar këtë lëndë në pune (se kjo lëndë më herët ka qenë në punë tek gjyqtarja, tani e ndjera [Sh. G.]) janë caktuar një mori seancash gjyqësore, janë dëgjuar shumë dëshmitar lidhur me këtë çështje juridiko penale të propozuar nga Prokuroria Speciale, por ka mbetur të dëgjohet vetëm edhe një dëshmitare e quajtur [S.A.] për të cilën gjykata ka tentuar që ta siguroj për seancën e shqyrtimit gjyqësor, por nga fletë kthesa e gjykatës është konstatuar se adresa e saj është e pa njohur, andaj gjykata pas kësaj, ka lëshuar urdhëresë policisë së Kosovës - st. policor "Qendra" në Prishtinë, për verifikimin e adresës së saj por edhe ky i fundit ka kthyer përgjigje se dëshmitarja në fjalë nuk gjendet në atë adresë të shënuar si në ftesë të gjykatës.

111. Në vijim, Gjykata Themelore thekson që: *"Trupi Gjykues lidhur me të gjitha veprimet e ndërmarrura për sigurimin e kësaj dëshmitare ja ka prezantuar edhe palëve në procedurë penale, por prokurori i çështjes, edhe të akuzuarit me mbrojtësit e tyre nuk kanë pranuar që të lexohet dëshmia e saj të dhënë në Policinë e Kosovës me autorizim të prokurorit, duke theksuar, prokurori se kjo është dëshmitare bashkëpunuese me prokurorinë, kurse të akuzuarit dhe mbrojtësit e tyre e konsiderojnë se kjo është dëshmitare relevante për këtë çështje juridiko- penale, nga se në momentin kur kjo ka dhënë dëshmi në Policinë e Kosovës pala akuzuese dhe mbrojtësit e saj nuk kanë pas rast ta sfidojnë këtë dëshmitare, andaj edhe propozojnë që gjithsesi të bëhet përpjekja maksimale për sigurimin e kësaj dëshmitare në shqyrtimin e ardhshëm gjyqësore.*

Tani Trupi Gjykses ka mbetur që për sigurimin e saj në seancën e ardhshme gjyqësore ti drejtohet me një shkresë Ministrisë së Drejtësisë - Departamentit për Bashkëpunim Juridiko Ndërkombëtar, pasi që sipas disa informacioneve jo zyrtare që i disponojm kjo dëshmitare gjendet në shtetin e Gjermanisë”.

112. Megjithatë, pavarësisht veprimeve procedurale të ndërmarra nga Gjykata Themelore dhe rrethanave objektive që ndërlidheshin me sigurimin e dëshmitares S.A. bashkëpunuese dhe ndryshimin e përbërjes së trupit gjykses, Gjykata konsideron se kohëzgjatja e procedurës penale mbetet e konsiderueshme dhe nuk e arsyeton një kohëzgjatje kaq të gjatë. Për më tepër, Gjykata Themelore në përgjigjen e saj nuk ka specifikuar se dëshmia e dëshmitares është përcaktuese për të pezulluar mbajtjen e seancave dhe po ashtu nuk ka ofruar sqarime konkrete se cilat janë rrethanat përcaktuese për vazhdimin e procedurës penale ndaj parashtruesit të kërkesës.
113. Gjithashtu, duke pasur parasysh numrin relativisht të kufizuar të seancave të mbajtura përgjatë viteve, si dhe shtyrjet dhe anulimet e tyre, Gjykata vlerëson se përgjegjësia për zvarritjen e procedurës nuk mund t'i atribuohet parashtruesit të kërkesës, por autoriteteve kompetente, të cilat kanë për detyrë organizimin dhe zhvillimin efikas të procedurave gjyqësore brenda një afati kohor të arsyeshëm.

(iv) Rëndësia e asaj çfarë është në rrezik për parashtruesin në kontest

114. Në lidhje me parimin e rëndësisë së asaj se çfarë është në rrezik për palën në kontest, Gjykata rikujton se sipas praktikës së konsoliduar të GJEDNJ-së, disa kategori të rasteve kërkojnë trajtim me dilgjencë të veçantë dhe zgjidhje prioritare, për shkak të ndikimit të drejtpërdrejtë që procedura mund të ketë mbi të drejtat dhe interesat themelore të palës. Sipas praktikës së GJEDNJ-së, rastet penale që përfshijnë akuza serioze, veçanërisht në rastin konkret edhe masa kufizuese ndaj pasurisë së personit të akuzuar, kërkojnë kujdes të posaçëm nga autoritetet kompetente dhe zhvillim të procedurës brenda një afati të arsyeshëm. Në këtë kontekst, rasti i parashtruesit të kërkesës ka të bëjë me zhvillimin e një procedure penale për akuza të rënda që ndërlidhen me krimin e organizuar, pastrimin e parave, keqpërdorimin e detyrës zyrtare, plaçkitjen dhe falsifikimin e dokumenteve zyrtare.
115. Thënë këtë, Gjykata vëren se ndaj parashtruesit të kërkesës, përveç zhvillimit të procedurës penale për një periudhë të gjatë kohore, janë ndërmarrë edhe masa të sigurimit pasuror, përfshirë sequestrimin e përkohshëm të parcelave të paluajtshme dhe ngrirjen e aseteve. Gjykata po ashtu vëren se procedura penale ndaj tij ka filluar që në vitin 2014 dhe, pavarësisht kalimit të më shumë se një dekade, ende nuk ka përfunduar me një vendim merititor. Në këto rrethana, Gjykata konsideron se, edhe pse parashtruesi i kërkesës ishte liruar nga paraburgimi, duke u lënë në liri gjatë zhvillimit të procedurës, natyra dhe serioziteti i akuzave, së bashku me masat kufizuese ndaj pasurisë së tij dhe pasigurinë juridike të zgatur ndër vite, kërkojnë “kujdes të posaçëm” nga autoritetet kompetente në trajtimin e kësaj çështjeje penale.

Përfundim në lidhje me pretendimin për shkeljen e paragrafit 2 të nenit 31 të Kushtetutës dhe paragrafin 1 të nenit 6 të KEDNJ-së

116. Si përfundim, Gjykata vlerëson se ndjekja dhe gjykimi lidhur me veprat penale të të tilla kërkon angazhim të lartë nga autoritetet publike për shkak se në rrethana të caktuara procedurat penale lidhur me natyrën e veprave të mund të jenë komplekse, sidomos kur një procedurë penale përfshin numër të konsiderueshëm të të pandehurve dhe të lartë të provave materiale.

117. Megjithatë, Gjykata konsideron se paragrafi 2 i nenit 31 të Kushtetutës garanton të drejtën për një proces të rregullt dhe të paanshëm gjyqësor, që ndër të tjera, parasheh zgjidhjen e çështjes penale brenda një afati të arsyeshëm kohor. Individët të cilët përballen me aktakuza për kryerjen e veprave penale kanë pritshmëri që akuzat ndaj tyre të marrin epilog sa më shpejt.
118. Gjykata, pavarësisht kompleksitetit të rastit dhe natyrës së akuzave të ngritura në aktakuzë, vlerëson se, megjithatë, nga fillimi i procedurës penale deri në fazën aktuale kanë kaluar më shumë se dhjetë (10) vite, periudhë kjo e cila, në kuadër të një procedure penale të zhvilluar në shkallë të parë të gjyqësorit, paraqet një kohëzgjatje tejet të konsiderueshme dhe vështirë të justifikueshme, pavarësisht vështirësive dhe pengesave procedurale që kanë shoqëruar zhvillimin e saj.
119. Në dritën e elaborimit të kriterëve të lartcekura dhe pas aplikimit të tyre në rrethanat konkrete të rastit, Gjykata vlerëson se Gjykata Themelore duhet të veprojë me prioritet dhe brenda një afati sa më të arsyeshëm kohor, duke pasur parasysh kohëzgjatjen tashmë të tejzgjatur të procedurës, me qëllim të përfundimit të procedurës penale dhe nxjerrjes së një aktgjykimi meritor.
120. Si përfundim, Gjykata konsideron se kohëzgjatja e procedurës penale e zhvilluar në Gjykatën Themelore ka rezultuar në cenimin e të drejtës së parashtruesit të kërkesës për një vendim gjyqësor brenda afatit të arsyeshëm kohor, të garantuar me paragrafin 2 të nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me paragrafin 1 të nenit 6 të KEDNJ-së.
121. Në dritën e konstatimit si më sipër, në rrethana të rastit konkret, Gjykata thekson se Gjykata Themelore duhet të ndërmerr të gjitha hapat e nevojshëm për ta përmbyllur lëndën penale [PPKR. nr. 130/16] me prioritet, dinamikë të shtuar dhe brenda një afati sa më të shpejtë kohor, konform gjetjeve të këtij Aktgjykimi.

Kërkesa për moszbulim të identitetit

122. Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës ka kërkuar moszbulim të identitetit të tij.
123. Lidhur me këtë, Gjykata i referohet rregullit 24 (1) të Rregullores së punës, i cili parasheh:

“(1) Kurdo përgjatë procedurës se shqyrtimit të një kërkesë individuale sipas paragrafit 7 të nenit 113 të Kushtetutës dhe deri në publikimin e vendimit përfundimtar, palët mund të kërkojnë që identiteti i tyre të mos zbulohet publikisht. Kërkesa duhet të jetë e arsyetuar”.

124. Lidhur me këtë, parashtruesi i kërkesës nuk ka arsyetuar pse identiteti i tij të mos zbulohet. Gjykata nuk gjen arsye që ta miratojë kërkesën për moszbulimin e identitetit të parashtruesit të kërkesës, rrjedhimisht e njëjta duhet të refuzohet (shih, në mënyrë të ngjashme, rastin e Gjykatës: [KI146/22](#), parashtrues *Ruzhdi Sefa*, Aktvendim për papranueshmëri i 20 marsit 2024, paragrafi 60; dhe [KI128/24](#) dhe [KI135/24](#) parashtrues *Sytrim Tafilaj dhe Leutrim Tafilaj*, Aktvendim për papranueshmëri i 28 janarit 2026, paragrafi 91-93).

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me paragrafët 1 dhe 7 të nenit 113 të Kushtetutës, me nenet 20 dhe 47 të Ligjit dhe me rregullat 24 (2) dhe 48 (1) (a) të Rregullores së punës, më 12 maj 2026, njëzëri:

VENDOS

- I. TË DEKLAROJË kërkesën të pranueshme;
- II. TË KONSTATOJË se ka pasur shkelje të paragrafit 2 të nenit 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës në lidhje me paragrafin 1 të nenit 6 (E drejta për një proces të rregullt) të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, përkitazi me të drejtën për një gjykim të drejtë dhe të paanshëm brenda një afati të arsyeshëm kohor;
- III. TË KONSTATOJË se Gjykata Themelore në Prishtinë-Departamenti Special duhet të veprojë me prioritet në përfundimin e procedurës penale dhe nxjerrjen e aktgjykimit meritior;
- IV. TË REFUZOJË kërkesën për moszbulim të identitetit;
- V. T'UA KUMTOJË këtë Aktgjykim palëve;
- VI. TË PUBLIKOJË këtë Aktgjykim në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës, në pajtim me paragrafin 4 të nenit 20 të Ligjit; dhe
- VII. TË KONSTATOJË që ky Aktgjykim hyn në fuqi në ditën e shpalljes në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës, në pajtim me paragrafin 5 të nenit 20 të Ligjit.

Gjyqtari raportues

Kryetari i Gjykatës Kushtetuese

Bajram Ljatifi

Nexhmi Rexhepi